



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMI I KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR PËR SHKOLLAT E
MESME TË GJUHËVE TË HUAJA**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: ITALISHT

KODI: 3.4.11.Zgj.(f)

PROGRAMI I LËNDËS

ITALISHT

PËR KLASËN E 11-të

NIVELI FILLESTAR

Koordinatori: Erifili Hashorva

Redaktori: Gazmend Krasniqi

Përgjegjës sektori: Marita Hamza

TIRANË, KORRIK 2010

Mësimdhënia e gjuhës italiane është një tjetër ndihmesë për formimin dhe aftësimin e përgjithshëm të nxënësit, duke i dhënë atij mjetet e duhura për të përballur situata të ndryshme, brenda dhe jashtë shkollës.

Është më se e nevojshme që në programin e lëndëve mësimore të përfshihen me shumë se dy gjuhë të huaja dhe padyshim që gjuha italiane zë një vend të rëndësishëm, pasi nxënësi njihet nëpërmjet gjuhës fakte kulturore të vendit fqinj, arrin të komunikojë në gjuhë të huaja dhe të përballlet me situata të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit.

Ky program e përgatit nxënësin për nivelin gjuhësor A2 sipas KPER-se.

Një i nivelit A2 mund të kuptojë fjali të shkëputura dhe shprehje të përdorura shpesh në lidhje me fusha që kanë përparësi imediate (për shembull, informacione personale apo familjare të thjeshta, blerje, mjedisi më i afërt puna etj). Mund të komunikojë gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta formimin e tij, mjedisin përreth tij si dhe të përmendë tema që u përkasin nevojave të tij të menjëherëshme.

1. SYNIMI I LËNDËS

Ky program synon që të drejtojë nxënësin drejt aftësimit në:

- zhvillimin e aftësive komunikative;
- përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të thjeshta të jetës së përditshme;
- kuptimin dhe përvetësimin e mesazheve të thjeshta të shkruara;
- kuptimin dhe përvetësimin e mesazheve të thjeshta gojore;
- prodhimin e mesazheve të thjeshta gojore;
- prodhimin e mesazheve të thjeshta të shkruara;

Në përfundimin e klasës së 11-të (gjuhë e tretë me zgjedhje) nxënësi duhet të ketë njohuritë bazë të një niveli bazë gjuhësor e kulturor.

2. Objektivat e përgjithshme

Në përfundim të këtij programi nxënësi,-ja duhet:

- të ketë vetëdijshmëri gjuhësore;
- të ketë vetëdijshmëri në komunikim,
- të zotërojë aftësi të tërthorta (p.sh, të bashkëpunimit, të komunikimit, të gjykitimit kritik, të mendimit krijues, të strategjive dhe reflektimeve të të nxënurit.
- të zotëroje aftësitë gjuhësore: të kuptuarit, të shprehurit me gojë dhe të kuptuarit me shkrim, duke bërë të mundur.
- të ketë kompetencë gjuhësore dhe komunikuese në situata të thjeshta ndërvepruese
- të kuptojë një bisedë në kushte normale dhe për tema që ai i njeh më pare;
- të lexojë pjesë të shkurtra dhe me një gjuhë të thjeshtë;
- të kuptojë dhe të dallojë format e thjeshta të komunikimit midis njerëzve dhe të bëjë dallimin me format e gjuhës amtare.

3. OBJEKTIVA

a) Objektivat sipas standardit në komunikim

Përshkrimi. Ky standard hedh bazat e gjuhës, pasi nxënësit sapo kanë filluar ndërveprimin në gjuhën italiane.

Nëpërmjet situatave të ndryshme, të përshtatshme për grupmoshën dhe nivelin gjuhësor, ky standard i mundëson nxënësit të përftojnë njohuri fillestare gjuhësore të nevojshme për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm në një mjedis gjuhësor e kulturor anglishtfolës.

Ky standard pasuron dijet e përgjithshme të nxënësit dhe e përgatit atë emocionalisht për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën.

	Objektiva
Komunikimi	Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet: <ul style="list-style-type: none">• të lexojë e të kuptojë njoftime të thjeshta,• të japë dhe të kërkojë të dhëna për një adresë apo vend,• të dijë të tregojë për shtëpinë, ambientin që e rrethon dhe orenditë,• të dijë të përshkruajë një send,• të përshkruajë pamjen e jashtme të dikujt,• të flasë për pushimet,• të shprehë dëshira dhe pakënaqësi,• të kuptojë e të japë këshilla,• të dijë të bëjë krahasime,• të kërkojë falje• -të kundërshtojë ose të pranojë.

b) Objektivat sipas standardit në kulturë

Përshkrimi. Objektivat e standardit në këtë fushë parashikojnë fillimet e ndërgjegjësimit kulturor ku nxënës/i,-ja i/e klasës së 11-të përfton njohuritë për elementet bazë të kulturës dhe i mishëron ato në mënyrën e prezantimit, përshkrimit, modelin e të treguarit të përvojës, të marrjes së fjalës, të dhënies së një këshille apo mendimi, me qëllim që nxënës/i,-ja të nxitet në njohjen e shprehive të një kulture tjetër dhe në vendosjen e kontakteve sociale bazë.

	Objektiva
Kulturë	Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet: <ul style="list-style-type: none">• të përdorë format e mirësjelljes fillestare kur përshëndetet me dik,• të paraqesë përvojën e vet me fjali të thjeshta,• të dallojë e të kuptojë thelbin e njoftimeve dhe udhëzimeve të thjeshta,• të hartojë një ftesë,• të dijë si pyetet për çmimin dhe sasinë e një artikulli,

	<ul style="list-style-type: none"> • të dijë të japë të dhëna për vendndodhjen apo drejtimin për diku, • të dijë të tregojë për motin, • të japë këshilla të thjeshta, • të dijë të porosisë e të prenotojë në restorant, dhomë apo biletë udhëtimi, • të kuptojë shprehjet e përdorura në një letër të thjeshtë ose tekst kënge, • të shkruajë një kartolinë dhe të dërgojë urime përshëndetjeje, • të plotësojë module të thjeshta mbi të dhënat personale të tij ose të dikujt tjetër, • të falenderojë dikë duke shkruar mesazhe të shkurtra me argumente të thjeshta.
--	--

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi. Ky standard aftëson nxënësin/sen të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit A1+. Strukturat gjuhësore në këtë nivel janë të thjeshta dhe realizohen nëpërmjet situatave të ndryshme ligjërimore, ku nxënës/i, -ja nxitet të praktikojë fjali dhe shprehje të thjeshta të gjuhës italiane, si dhe nxitet të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre në ligjërimin me gojë dhe me shkrim.

	Objektiva
Strukturën gjuhësore	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ të shqiptojë dhe shkruaj drejt fjalët, ✓ të shqiptojë dhe shkruaj drejt bashkëtingëlloret e dyfishta, ✓ të përdorë e shenjat t pikësimit, ✓ të përdorë drejt gjininë tek emrat, ✓ të përdorë mbiemra, përemrave vetore, ✓ të përdorë folje ndihmese dhe gjysmëndihmëse, folje vetvetore, ✓ në përdorimin e parafjalëve të thjeshta e të përbëra, ✓ në përdorimin e numërorëve, ✓ në përdorimin e ndajfoljeve të vendit, sasisë e të kohës, ✓ në përdorimin e foljeve të rregullta e të parregullta, ✓ në përdorimin e mënyrës urdhërore joformale, ✓ në përdorimin e mënyrës kushtore për të shprehur një dëshirë të realizueshme ose të porealizueshme.

4. Objektivat sipas aftësisë gjuhësore

Objektivat duhet të jenë të matshëm dhe konkretë për nivelin dhe moshën e nxënësit

Të dëgjuarit

Nxënësi,-ja:

- Tregon vëmendjen e duhur gjatë dëgjimit.
- Mban shënime për fjalët më të rëndësishme.
- Kap në tërësi kuptimin e një bisedë.
- Kap qëllimin e një komunikimi.
- Kupton mesazhe të thjeshta nga jeta e përditshme.

Të folurit

Nxënësi,-ja:

- Merr pjesë për të treguar përvoja të kaluara.
- Ndërhyn në një bisedë shkurt dhe me fjali të thjeshta por me kuptim.
- U përgjigjet pyetjeve saktë dhe shkurt.
- Përshkruan me fjali të thjeshta familjen, kushtet e jetës dhe karrierën shkollë.
- Tregon thjesht dhe shkurt përmbajtjen e një teksti të shkurtër e të thjeshtë.
- Shpreh një mendim ose opinion personal kundrejt një teme ose një bisede të thjeshtë shoqërore.
- Përshkruan mbresat që i kanë lënë udhëtimi ose pushimet.
- Përballon situata të ndryshme përballë një bashkëbiseduesi amtar si në një vend të huaj ashtu dhe në vendin e tij.
- Diskuton shkurt, thjesht e kuptueshëm mbi tema të njohura.

Të lexuarit

Nxënësi,-ja:

- Lexon tekste të shkurtra e të thjeshta
- Kupton një letër përshëndetje ose kartolinë
- Dallon fjalët e panjohura me anën e kuptimit dhe ndihmës së fjalëve të tjera të tekstit
- Kupton letrat personale të thjeshta e të shkurtra

Të shkruarit

Nxënësi,-ja:

- kupton tekste të shkruara mbi argumente që kanë të bëjnë me botën rinore dhe me interes e tij,
- kupton me lehtësi përshkrime mbi ndodhi, dëshira dhe ndjenja të ndryshme,
- shkruan tekste mbi argumente të ndryshme,
- të riprodhon një tekst të thjeshtë gojor dhe të modifikojë regjistrin gjuhësor të tij,
- të shkruan një kartolinë urimi,
- të përshkruan thjesht e shkurt një ngjarje nga jeta personale, shoqërore, familjare,
- të shkruan një mesazh mbi argumente personale,
- të përpilon një modul mbi të dhënat personale.

5. KËRKESA TË GJUHËS ITALIANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjuhët e huaja e ndihmojnë nxënësin edhe në afrimin e tij me lëndët e tjera. Kështu përfshirja në Kurrikulën Kombëtare të lëndëve si:

- Historia e artit
- Qytetaria
- Teatri
- Informatika
- Trashëgimia kulturore

tregon se sa ndikon njohja e gjuhës së huaj në perceptimin që nxënësi krijon për botën që e rrethon dhe se sa ndihmon kjo e fundit në asimilimin e këtyre lëndëve të tjera.

Lënda Gjuha Italiane do të ketë si një nga synimet e saj të së ardhmes pikërisht përforcimin dhe zgjerimin e njohurive gjuhësore për ta shndërruar në mbështetje për studimin e disiplinave të tjera. Në kohën tonë vjelja e materialeve në gjuhën e huaj është bërë një domosdoshmëri për përplotësimin e detyrimeve të disiplinave të tjera. Në këtë mënyrë i gjithë formimi në gjuhën italiane mund të japë një ndihmesë të drejtpërdrejtë për të kuptuar, vjelur, përshtatur mendime, sugjerime, zgjidhje sipas kërkesave më bashkëkohore të shkollës në mënyrë sistematike dhe të arsyetuar.

Nëpërmjet studimit të gjuhës Italiane do mundim të edukojmë tek nxënësit një ndjeshmëri dhe edukatë më të lartë qytetare. Një gjë e tillë e nxit formimin individual të nxënësit dhe të klasës në tërësi. I pasuron ata me mendim dhe me një qëndrim të ri për realitetin dhe për kontekstin ku jetojnë e studiojnë.

Është një mënyrë e drejtpërdrejtë e qasje me kulturën e vendit fqinj, dhe siguron një njohje më të shpejtë dhe vlerësim po ashtu të mënyrës së sjelljes, të qëndrimit, dhe të arritjeve. I paraprin stabilizimit të një komunikimi më frytdhënës me gjuhën dhe kulturën italiane në përgjithësi.

Ky program mbështet në dokumente të rëndësishme si:

- Kuadri i Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar
- Standardet e arritjes

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Shpërndarja e orëve mësimore

Programi i klasës së 11-të për nivelin fillestar është një dokument zyrtar, dhe si i tillë ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë përdoruesit e tij (mësues, nxënës, drejtues të arsimit në shkollat e arsimit të mesëm, inspektorë të gjuhës angleze në drejtoritë arsimore të qytetit e të qarkut).

Orët mësimore

Gjuha italiane për klasën e 11-të në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja zhvillohet me 3 orë mësimore në javë (**36 javë x 3 orë = 108 orë vjetore**) dhe shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 50 orë vjetore të cilat i përgjigjen: 35 orë për trajtimin e lëndës së re pra (70%) dhe 15 orë pra(30%) do të shërbejnë për përpunimin e tyre. **Formimi gjuhësor zë 58 orë** të tjera mësimore në të cilat mësuesi shtjellon njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore, gramatikore e leksikore.(70% e këtyre orëve do të shfrytëzohet për të trajtuar struktura të reja gjuhësore,pra 39 orë mësimore ndërsa 30%e tyre që përbëjnë 19 orë do të shërbejnë për përdorimin dhe përforcimin e tyre.

7. Vlerësimi

Nëse pedagogjia dhe praktikat didaktike përmbajnë një vlerësim, vlerësimi vetë përcakton pedagogjinë.

Të reflektosh mbi vlerësimin në përgjithësi do të thotë të rimendosh objektivat e mësimdhënies, strategjitë e adoptuara në pedagogji, pritshmëritë e shkollës kundrejt klasave si dhe nxënësit në veçanti.

Kështu pra vlerësimi është një mjet rregullues gjatë mësimdhënies dhe ndikon në përmirësimin e formimit të nxënësit si dhe në fleksibilitetin e hapjen në programimin e njësive didaktike.

Në shkollën e mesme theksi vihet në verifikimin e aftësive mbi bazën e objektivave dhe pritshmërive të shpjguara mëse qartë për nxënësit.

Mësimdhënia e elementëve gjuhësorë duhet të mbështetet tek përcaktorët gjuhësorë të Kuadrit të përbashkët të referencës për gjuhët.

Vlera e këtij dokumenti është e lidhur me nivelet që përkufizojnë shkallët e progresive të të nxënurit si dhe kompetencat e ndryshme gjuhësore. Ata mund të përdoren si përshkrues të prodhimit të nxënësve, por edhe si objektiva formues të cilëve mund t'u referohesh si dhe si mjete vlerësimi apo vetëvlerësimi.

Idealisht vetvlerësimi i nxënësit dhe vlerësimi i mësuesit duhet të përputhen:

- vetëvlerësimi i nxënësit dëshmon aftësinë e tij për të riflektuar mbi njohuritë, aftësitë dhe atë që është në gjendje të japë,
- vlerësimi nga ana e mësuesit jepet si një masë e jashtme e objektivave mbi këto njohuri, aftësi e prodhueshmëri.

Vlerësimi do të bëhet si me shkrim ashtu edhe me gojë, në bazë të programit të shpërndarjes së orëve mësimore, të llojeve të ndryshme si pyetësorë me pyetje të hapura apo teste me alternativa për të nxjerrë në pah njohuritë e nxënësit mbi elementët morfologjikë e sintaksorë, si dhe ndërhyrje në mësimet interaktive me anë të projekteve të ndryshme që do të trajtohen në këto orë. Gjithashtu vlerësimi do të bazohet edhe mbi ushtrime individuale apo grupi.

Përgjithësisht do të jenë 4 provime të shkruara vjetore dhe po aq gojore.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi do të jetë me notë nga nota 4 deri në 10, bazuar në sistemin e vlerësimit të vendosur nga MASH DHE AVA dhe do të bazohet tek këta tregues:

për vlerësimet me gojë:

- përvetësim dhe saktësi i prodhueshmërisë,
- kontrolli mbi njohuritë e përfutuara,
- aftësi përpunimi dhe përmbledhjeje të materialeve njohja/ zotërimi i elementëve të caktuar,
- aftësi ekspozuese të testuara (analizim, interpretim, kontestualizim, etj),
- aftësi ekspozuese dhe përdorim të gjuhëve specifike,
- aftësi përmbledhëse.

për vlerësimet me shkrim:

- realizimi gjuhësor
- koherenca dhe përshtatja me detyrat dhe format e ndryshme tekstuale
- kontrolli mbi njohuritë e përfutuara
- aftësim i përgjithshëm duke u bazuar tek origjinaliteti, aftësia kritike e përmbledhja si dhe tek frytshmëria e tekstit.

Këto parametra që përmban kurrikula, mund të artikulohen në brendësinë e tyre, nëse është e mundur me llojin e testimit, duke i dhënë më rëndësi herë pas here treguesit më të rëndësishëm. Në veçanti parametri i realizimit gjuhësor mund të detajohet me saktësi, në mënyrë që të nxjerrë në pah dhe të marrë në konsideratë të gjithë treguesit që hynë në këtë kontekst (saktësia ortografike, morfologjike e sintaksore; kohezioni i tekstit, saktësia leksikore, përdorimi i regjistrit, etj). Parametri i sipërpërmendur mund të ketë, duke i ardhur në ndihmë vlerësimit, një “peshë” të madhe .

Sa shpesh dhe si mund të realizohet vlerësimi.

Përgjatë zhvillimit të njësive didaktike do të realizohen testime nëpërmjet ushtrimeve, përmbledhjeve, analizave të teksteve, prodhimeve të teksteve, debateve, ndërhyrjeve dhe ngritjes në mësim. Në përfundim të njësive apo njësive do të zhvillohen prova të llojeve të ndryshme, në bazë të argumenteve të trajtuar (përmbledhje, analiza teksti, ushtrime, prova gjysëm të strukturuar)

Për prodhimin me gojë, parashikohen këto lloj testesh:

- përgjigje me gojë
- marrja pjesë në argumente të caktuara
- marrja pjesë në leksione interaktive (analizë/interpretim teksti) apo në përfundim të mësimëve frontale.

Për prodhimin me shkrim, parashikohen:

- një minimum prej katër provash vjetore (analiza teksti, ese të shkurtra, artikuj gazetash, tema aktualiteti/historie),
- prova të ndryshme me shkrim si detyra shtëpie për të cilat do të jepet një vlerësim me qëllim orientues,
- parashikohet mbështetja tek pyetësorët e strukturuar apo gjysëm të strukturuar me vlerë përfshirëse në provat me gojë,
- për të stimuluar thellimin e disa aspekteve të caktuara, parashikohet organizimi i punëve më të thelluara nga ana e nxënësit, individualisht apo në grupe.

Tregues për vlerësimin final të lëndës:

- interesi dhe pjesëmarrja e nxënësit gjatë vitit shkollor,
- zotërim/ aftësi i njësive didaktike dhe elementëve të tyre,
- aftësitë e veçanta (të fiksuara në bazë të objektivave të programit mësimor),
- aftësitë gjuhësore dhe komunikuese.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është një element i domosdoshëm dhe plotësues i vlerësimit nga mësuesi. Si mjet në vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ) që me anë të tri pjesëve të tij Pasaportës Gjuhësore, bibliografisë dhe dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor duke vetëvlerësuar njohuritë e marra. Me anë të këtij elementi nxënësi vlerëson punën e njëri-tjetrit në grup. Më pas nxënësit e tjerë bashkë me mësuesin paraqesin komentim përfundimtar. Vetëvlerësimi është edhe një faktor i rëndësishëm për të motivuar nxënësin për të organizuar një nxënie më të mirë të gjuhës. Kështu që nga kjo pikë përfiton edhe nxënësi por edhe mësuesi në të njëjtën kohë.

Vetëvlerësimi ka efekt kur:

- u referohet normave dhe kapacitetit që Kuadri i Referencave për Gjuhët parashtron për grupmoshën e nivelin e tyre,
- është i lidhur me një përvojë të veçantë, gjuhësore e ndërkulturore.

Vënia e synimeve të qarta në program, mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi. Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ), që me anë të tri pjesëve të tij: Pasaportës Gjuhësore, Biografisë gjuhësore dhe Dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore të cilat mund të jenë: provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.